



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMEVE NË ZGJEDHJE

(PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËRGJIGJA E DUHUR PËR
KRIMET PARA, GJATË DHE PAS DITËS SË VOTIMIT NË ZGJEDHJE)



*PROJEKTI "RRITJA E PJEËMARRJES QYTETARE NË PROCESET ZGJEDHORE NË KOSOVË"
NË KUADËR TË KOALICIONIT PËR INTEGRITET ZGJEDHOR (KIZ)*

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Tetor 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Korniza ligjore për veprat penale kundër të drejtës së votimit.....	6
3. Bashkëpunimi ndër institucional për zgjedhjet	7
4. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) në mes Prokurorisë dhe Policisë	9
5. Efektet e zbatimit të PSV-ve në parandalimin dhe luftimin e vjedhjes së votave.....	11
a. Zbatim i PSV-ve, rol proaktiv i institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes.....	11
b. Mangësitë e PSV-ve, politikë e kufizuar e ndjekjes	14
6. Politika e dënimeve në rastet e krimeve të zgjedhjeve	18
7. Monitorimi i seancave gjyqësore lidhur me rastet e krimeve të zgjedhjeve	21
8. Rekomandimet e IKD-së për plotësimin dhe ndryshimin e PSV-ve	23

1. Përmbledhje ekzekutive

Si rezultat i zgjedhjeve të vitit 2010, të cilat ishin përcejllur me shumë parregullsi, manipulime dhe reagim të faktorit vendor dhe ndërkombëtar, Kryeprokurori i Shtetit, sipas rekomandimeve të IKD-së, kishte vendosur të zbatonte një politikë proaktive për zgjedhjet e 3 nëntorit 2013, të bazuar në parandalim dhe në ndjekje proaktive të veprave penale kundër të drejtave të votimit. Duke u bazuar në legjislacionin pozitiv në Kosovë, PSh në bashkëpunim me IKD-në, kishte hartuar Memorandumin e Bashkëpunimit, përmes të cilit ishte krijuar një bashkëpunim ndër-institucional me të gjitha institucionet relevante të drejtësisë të përfshira në procesin e zgjedhjeve të 3 nëntorit 2013.

Si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës me ndihmën e IKD-së kanë hartuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre institucioneve për të reaguar në parandalimin dhe luftimin e kryerjes së veprave penale që ndërlidhen me zgjedhjet. Rezultatet konkrete të këtij bashkëpunimi u dëshmuar gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve 2013, por edhe të zgjedhjeve pasuese qoftë komunale apo të përgjithshme deri në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtur më 11 tetor 2017, në të cilat pati ulje drastike të rasteve të manipulimit të zgjedhjeve. IKD vlerëson se PSV-të kanë qenë trugu i bashkëpunimit efikas të paparë deri më tani sa i përket hetimit dhe ndjekjes së krimeve të caktuara në Kosovë, duke rritur gatishmërinë e veprimit nga policia dhe prokuroria.

IKD vlerëson se dita e votimit, nuk do të jetë më problematike, nëse institucionet e drejtësisë, do të zbatojnë me përpikëri PSV-të dhe obligimet ligjore në parandalim dhe ndjekje të kryesve të veprave penale kundër të drejtës së votimit. Problem, mbeten format tjera të manipulimit të proceseve zgjedhore dhe keqpërdorimit të drejtës së votuesve. Fjala është për keqpërdorimet që ndodhin para dhe pas ditës së votimit në procesin e zgjedhjeve.

IKD vlerëson se krimet e zgjedhjeve janë të ndërlidhura me aktivitete tjera kriminale, të cilat ndërlidhen me zgjedhjet por nuk fillojnë dhe nuk mbarojnë me ditën e votimit. Në këtë drejtim, përfshihen disa faza dhe fenomene të ndryshme, të cilat burojnë nga mënyra e dyshimtë e financimit të partive politike, çështje kjo, e cila është ngritur vazhdimisht nga IKD dhe organizatat tjera të shoqërisë civile.

Përderisa, PSV-të në një masë të madhe koncentrohen në ndërmarrjen e veprimeve të policisë dhe prokurorisë në ditën e votimit të zgjedhjeve, fushatës parazgjedhore duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur, përmes plotësimit të PSV-ve në fazën para dhe pas ditës së votimit në zgjedhje.

Në fazën para ditës së votimit, zgjedhjet përcillen me fushatë parazgjedhore, në të cilën, po të kishte një ndjekje efikase të PSh-së do të mund të zbuloheshin shumë veprime të

kundërligjshme, të cilat hynë në sferën kriminale. Fjala është për financimin e partive politike. Në këtë fazë, IKD rekomandon që PSh të caktojë prokurorë të veçantë për zgjedhjet për secilën komunë të Kosovës, të cilët do të fokusoheshin në monitorimin e aktiviteteve të fushatës parazgjedhore, përmes hetuesve të veçantë, përmes informacioneve që publikohen në media dhe duke ofruar qasje për publikun për të informuar në një linjë të sigurt të komunikimit në mënyrë anonime përmes telefonit dhe internetit. Në këtë formë, do të mundësohej fillimisht parandalimi i financimit të dyshimtë të partive politike, të cilat, pas informimit që PSh do të hetoi këto veprimtari të financimit, do të minimizonin aktivitetet e financimit të dyshimtë dhe më pas poqëse do të ndodhnin këto veprime të dyshimta, do të ndiqeshin me efikasitet nga organet e ndjekjes.

IKD vlerëson se pas përfundimit të ditës së votimit dhe shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, PSh duhet të ndërmarr veprime në drejtim të analizimit të veprimeve në fushën e prokurimit publik, fushë kjo në të cilën buxheti publik keqpërdoret në formën e shpërblimit të bizneseve dhe financieve të tjerë, të cilët kanë financuar partitë politike apo kandidatët e caktuar në fushatë parazgjedhore.

Baza e të dhënave të PSh-së e krijuar gjatë fushatës zgjedhore për aktivitetet e financuara të partitë politike nga bizneset dhe individët e caktuar, do të mundësonte një pistë të mirë të hetimit dhe ndjekjes për prokurorët, të cilët do obligoheshin të hetojnë lidhjet e financimit të partive politike dhe shpërblimit të financuesve me tenderë publik.

Në këtë formë, do të mundësohej fillimisht parandalimi i financimit të dyshimtë të tenderëve publik tek bizneset apo individët që kanë financuar partitë politike, të cilat, pas informimit që PSh do të hetoi këto veprimtari të financimit, do të minimizonin aktivitetet e financimit të dyshimtë të bizneseve apo individëve përmes tenderëve publikë dhe më pas poqëse do të ndodhnin këto keqpërdorime, ato do të ndiqeshin me efikasitet nga organet e ndjekjes.

2. Korniza ligjore për veprat penale kundër të drejtës së votimit

Për të mundësuar një luftë sa më efikase dhe efektive në ndjekje dhe gjykim të manipulimeve në zgjedhje, legjislacioni në Republikën e Kosovës në Kodin Penal të Republikës së Kosovës i ka kushtuar një kapitull të veçantë këtyre veprave. Derisa, Kapitulli XVI “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut” i Kodit të vjetër Penal i Kosovës përmbante gjashtë vepra penale që ndërlidheshin me zgjedhjet,¹ Kodi i ri Penal tanimë përmban 11 vepra penale.² Kuvendi i Kosovës përmes ndryshimeve ligjore i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtave të votimit. Në Kodin e ri Penal ka një ashpërsim të dënimeve për veprat penale kundër të drejtave të votimit, duke i kategorizuar ato si krime të rënda.

Veprat e reja sanksionojnë veprimet inkriminuese në tri faza përgjatë procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë vepra penale që mund të kryhen para ditës së votimit, gjatë ditës së votimit dhe pas ditës së votimit.³ Zgjedhjet nacionale të vitit 2010 janë evidentuar si zgjedhjet më të këqija të organizuara pas përfundimit të luftës në Kosovë. Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve ishin përfshirja në manipulime kryesisht e komisionerëve të zgjedhjeve. Kodi i ri Penal ka ashpërsuar dukshëm dënimet ndaj kësaj kategorie, ku në secilin rast kur secila prej veprave penale mund të kryhet nga komisionerët e zgjedhjeve dënimet janë tejet të ashpra.⁴

¹Shënim: Kodi i vjetër Penal i Republikës së Kosovës ishte baza e legjislacionit penal për sanksionimin e veprimeve kriminale në zgjedhje, i cili u kishte kushtuar një rëndësi të veçantë këtyre veprave, të cilat përcaktoheshin në nenet 176, 177, 178, 179, 180 dhe 181. Këto nene sanksionojnë veprimet kriminale ndaj të gjithë personave të cilët në çfarëdo mënyre pengojnë votuesit që të ushtrojnë të drejtën e votës, ndërmarrin çfarëdo veprimtarish korruptive, përdorin dhunë në ditën e votimit, votojnë disa herë të njëjtën votues, zbulojnë votën e fshehtë, mashtrojnë në votime dhe asgjësojnë në forma të ndryshme dokumentet e votimit. Dënimet e parapara në këto dispozita ligjore parashohin dënime me gjobë, kusht dhe burgim efektiv deri në pesë (5) vjet. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XVI: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, Kuvendi i Republikës së Kosovës, prill 2003.

² Avancimi i legjislacionit penal në këtë drejtim përkufizon veprimet kriminale kundër të drejtave të votimit që ndërlidhen me: cenimin e së drejtës për të kandiduar, kanosjen e kandidatit, parandalimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar, cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve, keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, dhënien ose marrjen e ryshfetit në lidhje me votimin, keqpërdorimin e të drejtës së votimit, pengimin e procesit të votimit, cenimin e fshehtësisë së votimit, falsifikimin e rezultateve të votimit, asgjësimit të dokumenteve të votimit.

³ Shënim: Veprat penale nga kapitulli XVIII, “Veprat penale kundër të drejtave të votimit” mund të kryhen përgjatë gjithë procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë veprimet kriminale para, gjatë dhe pas ditës së votimit. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në përgatitje të zgjedhjeve sanksionohen në nenet 210 “Cenimi i së drejtës për të kandiduar” dhe 211 “Kanosja e kandidatit”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në përgatitje dhe në ditën e zgjedhjeve sanksionohen në nenet 212 “Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar”, neni 214 “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve” dhe neni 215 “Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në ditën e zgjedhjeve sanksionohen në nenet 213 “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, 216 “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit”, neni 217 “Pengimi i procesit të votimit” dhe neni 218 “Cenimi i fshehtësisë së votimit”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në ditën e zgjedhjeve pas mbylljes së procesit të votimit sanksionohen në nenet 219 “Falsifikimi i rezultateve të votimit” dhe 220 “Asgjësimi i dokumenteve të votimit”.

⁴ Shënim: Kodi i ri përcakton vepra penale, të cilat përqendrohen te komisionerët e zgjedhjeve, ndaj të cilëve në secilin rast dënimet ashpërsohen si në vijim: Nëse veprat penale nga neni 212 dhe 218 kryhen nga komisionerët e zgjedhjeve dënimet janë minimum prej 1 deri në 5 vite burgim. Nëse vepra penale nga neni 214 kryhet nga komisionerët e zgjedhjeve dënimi është minimum prej 2 deri në 5 vite burgim. Nëse veprat penale nga neni 215,

IKD vlerëson se 11 veprat penale që sanksionojnë veprimet kriminale që ndërlidhen me zgjedhjet në Kodin Penal përkufizojnë mjaftueshëm të gjitha veprimet dhe mënyrat e kryerjes së këtyre veprave penale rreth procesit të zgjedhjeve dhe të drejtave të votimit në Kosovë.

3. Bashkëpunimi ndër institucional për zgjedhjet

IKD në publikimet e para vendore rreth ndjekjes dhe dënimeve për rastet e zgjedhjeve,⁵ pasi ka analizuar në të kaluarën dështimet në politikën e ndjekjes dhe dënimeve, kishte rekomanduar një rol proaktiv të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për të parandaluar dhe luftuar me sukses manipulimet e zgjedhjeve.

Si rezultat i zgjedhjeve të vitit 2010, të cilat ishin përcejllur me shumë parregullsi, manipulime dhe reagim të faktorit vendor dhe ndërkombëtar, Kryeprokurori i Shtetit, sipas rekomandimeve të IKD-së, kishte vendosur të zbatonte një politikë proaktive për zgjedhjet e 3 nëntorit 2013, të bazuar në parandalim dhe në ndjekje proaktive ndaj kryesve të veprave penale kundër të drejtave të votimit. Duke u bazuar në legjislacionin pozitiv në Kosovë, PSh në bashkëpunim me IKD-në, kishte hartuar Memorandumin e Bashkëpunimit, përmes të cilit ishte krijuar për herë të parë një bashkëpunim ndër-institucional në mes të gjitha institucioneve relevante të drejtësisë dhe sigurisë të përfshira në procesin e zgjedhjeve të 3 nëntorit 2013. Më 18 shtator 2013, sipas iniciativës së ish-Kryeprokurorit të Shtetit, z. Ismet Kabashi, për herë të parë ishte nëshkruar Memorandum Bashkëpunimi në mes të Këshillit Prokuroial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Policisë së Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.⁶

Qëllimi i këtij memorandumi ishte ngritja e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve të lartëpërmendura, në ndërmarrjen e aktiviteteve për luftimin me sukses, përfshirë parandalimin, e të gjithë atyre që bien ndesh me dispozitat e ligjit në fuqi lidhur me veprat penale kundër të drejtave të votimit, që do të mbaheshin në vitin 2013.

Si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës me ndihmën e IKD-së kanë hartuar Procedurat Standarde të Veprimit⁷ për të rritur efikasitetin dhe

216, 219 dhe 220 kryhen nga komisionerët e zgjedhjeve atëherë dënimi minimal për ta është prej 3 deri në 5 vite burgim.

⁵ Musliu B. dhe Gashi A. "Krimi i organizuar në zgjedhje: Analizë e politikës së ndjekjes dhe dënimeve". 6 qershor 2012, Prishtinë. Instituti i Kosovës për Drejtësi.

⁶ Shënim: Ishte Kryeprokurori i Shtetit, Ismet Kabashi, i cili kishte ftuar organet sikurse Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, për të përpiluar dhe nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për zgjedhjet 2013. Memorandum Bashkëpunimi në mes KPK, KGJK, PK, KQZ, dhe PZAP lidhur me zgjedhjet 2013, 18 shtator 2013. Kjo praktikë ishte vazhduar edhe për zgjedhjet e tjera të organizuara në Kosovë si për zgjedhjet lokale ashtu edhe nacionale.

⁷ Shënim: PSh dhe PK kanë hartuar PSV-të në bashkëpunim dhe me ndihmën e IKD-së, e cila ka draftuar këto PSV, të cilat janë modifikuar dhe janë miratuar më 26.09.2013 nga PSh dhe PK.

efektivitetin e këtyre institucioneve për të reaguar në parandalimin dhe luftimin e kryerjes ë veprave penale që ndërlidhen me zgjedhjet. Në fakt, arritja më e madhe si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit ishte krijimi i PSV-ve, të cilat kishin saktësuar veprimet për hetim dhe ndjekje efikase të veprave që ndërlidhen me zgjedhjet, gjithnjë duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga e kaluara dhe përvojat më të mira bazuar në ligjet në fuqi. PSV-të ishin rekomandim i drejtpërdrejtë nga IKD, e cila kishte hartuar PSV-të, të cilat më pas PSh përmes një grupi punues i kishte finalizuar dhe kishte vendosur së bashku me PK-në t'i zbatojnë për të shtuar efikasitetin dhe efektivitetin në ndjekjen e veprave penale kundër të drejtës së votimit. Sikurse në raportet preliminare, IKD vlerëson se PSV-të kanë qenë trngu i bashkëpunimit efikas të paparë deri më tani sa i përket hetimit dhe ndjekjes së krimeve të caktuara në Kosovë, duke rritur gatishmërinë e veprimit nga policia dhe prokuroria.⁸

Rezultatet konkrete të këtij bashkëpunimi u dëshmuar gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve 2013, por edhe të zgjedhjeve pasuese qoftë komunale apo të përgjithshme deri në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtur më 11 tetor 2017.

Kjo praktikë e mirë ka vazhduar ndër vite, ndërsa koordinimi i institucioneve përgjegjëse vazhdimisht ishte bazuar në legjislacionin pozitiv dhe Memorandumin e Bashkëpunimit, prej të cilit kishin derivuar procedura standarde të veprimit dhe planet e veprimit lidhur me zgjedhjet.

Përfundimisht, përgjithësisht rezultatet pozitive të treguara në koordinimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve, të cilat janë vlerësuar si nga vendorët ashtu dhe nga ndërkombëtarët si zgjedhje të organizuara mirë, fer dhe demokratike. Përveç incidenteve për të cilat ka pasur më pas kallëzime penale dhe aktakuza, vëzhguesit e Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) kanë theksuar se “megjithatë, zgjedhjet u ndikuan negativisht nga dobësitë e vjetra, veçanërisht nga listat e pasakta të votuesve që janë të cenueshme ndaj mashtrimeve, një sistem zgjedhor që lë mundësi për abuzim, dhe një sistem me shumë të meta për votim jashtë Kosovës.” Sipas tyre, “në zonat me shumicë serbe, procesi zgjedhor u dëmtua nga frikësimi dhe rastet e dhunës brenda komunitetit serb të Kosovës kundër kandidatëve dhe votuesve. Po ashtu pati një reagim të pamjaftueshëm nga prokuroria dhe policia ndaj atyre incidenteve”.⁹

⁸ Policia, Prokuroria dhe KQZ-ja të gatshme për zgjedhjet e 11 qershorit. Koha.net. 24 maj 2017. (Shih linkun <http://www.koha.net/arberi/20626/policia-prokuroria-dhe-kqz-ja-te-gatshme-per-zgjedhjet-e-11-qershorit/>)

⁹ Vëzhguesit e BE-së: Zgjedhje vërtet konkurruese, por me disa dobësi të vjetra. Ekonomiaonline. 13 qershor 2017. (Shih linkun <http://www.ekonomiaonline.com/politike/vezhguesit-e-be-se-zgjedhje-vertet-konkurruese-por-me-disa-dobesi-te-vjetra/>)

4. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) në mes Prokurorisë dhe Policisë

Procedurat Standarde të Veprimit për herë të parë në mes të PSh-së dhe PK-së me ndihmën e IKD-së ishin miratuar më 26 shtator 2013. Qëllimi i tyre është specifikimi i veprimeve të përbashkëta standarde mes Prokurorëve dhe Policisë nga fillimi i procesit zgjedhor deri në përfundim të procesit zgjedhor. Procedurat përcaktonin veprimet specifike të prokurorëve dhe policisë për të eliminuar mundësitë e keqpërdorimit para, gjatë dhe pas ditës së votimit në zgjedhje, duke pasur në fokus reagimin e shpejtë në secilin informacion mbi keqpërdorimin e zgjedhjeve, respektimin e të drejtave të të pandehurve në procedurë penale si dhe informimin e shpejtë të publikut në lidhje me secilin incident të mundshëm. Të njëjtat PSV janë modifikuar¹⁰ dhe kanë vazhduar të zbatohen në të gjitha zgjedhjet e organizuata pas vitit 2013.

Duke vlerësuar praktikën e keqe të ditës së votimit në zgjedhjeve të kaluara, rregullimi i PSV-ve është vendosur pikërisht në mënyrën e parandalimit dhe luftimit të keqpërdoruesve në ditën e votimit. Në këtë drejtim, PSV-të kanë krijuar obligime të ndërsjella në mes të Policisë dhe Prokurorit të Shtetit, në ditën e votimit, të cilat me rastin e zbatimit në praktikë, kanë arritur qëllimin e tyre. Megjithatë, format tjera të keqpërdorimit të procesit zgjedhor që ndërlidhen me veprimet para dhe pas ditës së votimit, kanë mbetur të parregulluara përmes PSV-ve, duke lënë mundësi të shumta të keqpërdorimit. Për këto mundësi, do të bëhet një elaborim më i thuktë, në pjesën e mëposhtme të raportit, ndërsa në vijim, janë bashkangjitur PSV-të që janë në fuqi që kanë të bëjnë me veprimet standarde të Policisë dhe Prokurorisë në ditën e votimit në proceset zgjedhore.

¹⁰ *Shënim:* Përveç Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të institucioneve të drejtësisë, në shtator 2017 Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës kishin modifikuar PSV-të. *Procedurat Standarde të Veprimit – Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës*. 25 shtator 2017.

PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT - PSV

1. Policia në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit në çdo rast ku ka dyshim të bazuar se është kryer vepra penale nga personi/a, i cili/a dyshohet se kryen veprime kundër të drejtave të votimit gjatë procesit zgjedhor (të cilat veprime janë të sanksionuara me KPK), me urgjencë dhe prioritet ndërmarrin veprime procedurale të parapara me KPPRK, duke bërë hetimin paraprak për grumbullimin e provave/fakteve në raste se ka indicie që vepra penale është kryer apo është tentuar të kryhet nga person/a të dyshimtë gjithmonë duke respektuar ligjet pozitive të RKS-së që rregullojnë fushën ligjore për zgjedhjet.
2. Policia me urgjencë/aty për aty në afat optimal njofton prokurorin për ndalimin e personave, i cili vendos mbi ndalimin e menjëhershëm, me qëllim të procedimit të rastit.
3. Policia siguron vendin e ngjarjes, mbledh provat relevante dhe merr deklaratat nga dëshmitarët e mundshëm.
4. Në rastet kur veprat penale kundër të drejtave të votimit kryhen nga qytetarët apo çfarëdo personi tjetër, policia njofton prokurorin, i cili vendos për masën e arrestit.
5. Në rastet kur vepra penale kundër të drejtave të votimit kryhen nga qytetarët apo çfarëdo personi tjetër, policia njofton prokurorin, i cili vendos për masën e ndalimit.
6. Policia për arrestimin e personave zyrtarë (Menaxheri i Qendrës së Votimit, kryesuesi, anëtarët e këshillit të Vend-Votimit, asistentët e Qendrës së Votimit dhe personeli i tavolinës ndihmëse në Qendrën e Votimit), gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare lidhur me votimin njofton zyrtarin e lartë komunal të zgjedhjeve për Komunë, me qëllim të zëvendësimit me anëtarë tjerë të KVV nga stafi rezervë.
7. Në të gjitha rastet për të cilat ka informata se në qendrat e votimit dhe në vendvotime ka keqpërdorime të procesit zgjedhor nga stafi i emëruar nga KQZ-ja, kryesuesi i KVV-së dhe anëtarët e tjerë, të cilët janë të obliguar të raportojnë keqpërdorimet gjatë zgjedhjeve mbi të drejtën e votimit dhe nuk e bëjnë një gjë të tillë, Policia e Kosovës urgjentisht ndërmerr veprime operative/hetimore me qëllim të verifikimit të këtyre pretendimeve dhe për informacionet e konfirmuara, përmes kanaleve të komunikimit të PK-së, njoftohet urgjentisht prokurorin, i cili vendos për iniciimin e procedurave të nevojshme ligjore.
8. Policia në bashkëpunim me Prokurorin kujdestar ndalojnë të gjithë personat, personat përgjegjës dhe zyrtarët, të cilët deklarojnë rrejtshëm kryerjen e ndonjë vepre penale, tek institucionet e zbatimit të ligjit.
9. Gjatë “Ditës Z” (dita e zgjedhjeve), në cilindo nivel që mbahen zgjedhjet (përgjithshme apo lokale), në koordinim do të formohen ekipe të përbashkëta të Prokurorëve dhe Hetuesve nga PK, të cilët do të ndërveprojnë, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet hetimore në ditën konkrete kudo që paraqitet nevoja në territorin që ata mbulojnë sipas Kompetencës Territoriale dhe Lëndore.
10. Policia e Kosovës merr për obligim që të sigurojë kushtet për punë të ekipeve të përbashkëta në Rajonin/Stacionin Policor, ku përfshihen zyrat, pajisjet elektronike dhe transportin. Gjithashtu, në Drejtorinë Rajonale të PK-së do të ketë ekipe kujdestare të specialistëve të krim teknikës, të cilët do të kërkohet të dalin në vendngjarje, nëse do të jetë e nevojshme mbledhja e provave për procedurë hetimore.
11. Kushdo që në keqpërdorim të varësisë ekonomike të votuesve, iu kryen atyre shërbime me qëllim të ndikimit tek ata që të votojnë në mënyrë të caktuar ose të mos votojnë, dhe kjo kuptohet nga policia, ata do të identifikohen nga Policia dhe pas konsultimit me prokurorin do të ndalohen.
12. Policia e Kosovës njofton me urgjencë Koordinatorin e Policisë së Kosovës për procesin zgjedhor rreth të gjitha veprimeve që ndërliken me ndalimin/arrestimin e personave të dyshuar.
13. Prokurorët kujdestar me urgjencë informojnë Koordinatorin Nacional rreth të gjitha veprimeve që ndërliken me ndalimin/arrestimin e personave të dyshuar.
14. Koordinatorin nacional dhe koordinatori nga Policia e Kosovës, sa më shpejtë që është e mundur informojnë publikun me informata zyrtare rreth rasteve penale të cilat ndodhin gjatë procesit zgjedhor. Informatat e njëjta më pastaj mund të lëshohen nga prokurori kujdestar edhe në nivel lokal në varësi të interesimit të mediave lokale.

Tabela 1: Procedurat Standarde të Veprimit.

5. Efektet e zbatimit të PSV-ve në parandalimin dhe luftimin e vjedhjes së votave

IKD si organizata e parë që ka ndërtuar një praktikë të monitorimit të institucioneve të drejtësisë në trajtimin e rasteve që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit, vlerëson qasjen dhe standardin e PSh-së në trajtimin me prioritet të këtyre rasteve. Ky standard për herë të parë në bashkëpunim me IKD-në dhe institucionet tjera u ndërtua në zgjedhjet lokale të vitit 2013, u avancua në zgjedhjet nacionale 2014, ndërsa ka vazhduar njëjtë edhe në zgjedhjet nacionale të 11 qershorit 2017. Tashmë në Kosovë, zgjedhjet janë të lira, demokratike dhe fer, të cilat njihen nga partitë politike dhe faktori ndërkombëtarë, pavarësisht incidenteve të vogla që janë shënuar, por për të cilat ka pasur një reagim adekuat të institucioneve të drejtësisë, në këtë rast duhet theksuar policinë dhe prokurorinë. Si asnjëherë më parë, në lidhje me rastet e incidenteve të evidentuara në zgjedhjet nacionale të 11 qershorit 2017 menjëherë janë ngritur aktakuza ndaj kryesve të dyshuar për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Koha e ngritjes së aktakuzave në këto raste, nëse krahasohet me rrethanat e Kosovës dhe praktikat e rasteve tjera të sistemit të drejtësisë, mund të vlerësohet si kohë e arsyeshme dhe rekorde.¹¹

a. Zbatim i PSV-ve, rol proaktiv i institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes

PSV-të për herë të parë “zgjuan” nga gjumi sistemin prokurorial, i cili u mobilizua në të gjitha aspektet, duke krijuar koordinimin ndër-institucional, sidomos në mes të Policisë dhe Prokurorisë.

Për dallim nga e kaluara, tashmë shpallja e datës së zgjedhjeve, paraqet “alarm” për institucionet e drejtësisë, të cilat mobilizohen në mbrojtje të votës së qytetarit.¹² Prezenca e shpeshtë e policisë në ditën e votimit, nuk paraqet pamje të mirë, për shkak së dita e votimit, në çdo vend demokratik, duhet të paraqet një ditë të qetë, në të cilën në mënyrë demokratike, qytetarët shprehin vullnetin e tyre, duke votuar të preferuarit e tyre.¹³ Sidoqoftë, deri në krijimin e një standardi të pranueshëm në shoqërinë kosovare, IKD vlerëson se reagimet policore në mbrojtje të votës së qytetarit janë të nevojshme dhe me kohë duhet të minimizohet prezenca e policisë në ditën e votimit.

¹¹ Musliu B. dhe Miftaraj E. “Drejtësia në zgjedhjet 2017”. 14 gusht 2017, Prishtinë. Instituti i Kosovës për Drejtësi.

¹² Kërkohet mobilizim për t’i pamundësuar manipulimet në zgjedhje. Telegrafi.com. 18.05.2017. (shih linkun <https://telegrafi.com/kerkohet-mobilizim-per-ti-pamundesuar-manipulimet-ne-zgjedhje/>)

¹³ IKD intervistë me z. Kujtim Kërveshi, ekspert juridik. Shtator 2018.

Praktika e ndërtuar në zgjedhjet lokale të vitit 2013, ka rritur rolin proaktiv të institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes.¹⁴ Në këtë drejtim, ekipet e Policisë së Kosovës në pjesën operative në ditën e votimit në zgjedhje, ndërmarrin veprime të shumta, për të qenë të gatshëm për të vepruar në secilën situatë që mund të krijohet në drejtim të manipulimit të procesit zgjedhor.¹⁵ Ekipet mobile përfshijnë mbi 5000 policë, të ndarë në: ekipet mobile të Policisë në të gjitha qendrat e votimit, ekipet e policëve civile si dhe ekipet e tjera hetuese. Ndërkaq, Prokurori i Shtetit ka krijuar ekipe të përbashkëta me Policinë si dhe mbi 100 prokurorë kujdestar në ditën e zgjedhjeve në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.¹⁶

IKD është organizata e vetme, e cila ka ndërtuar për herë të parë, praktikën e monitorimit të institucioneve të drejtësisë në reagimet e tyre në rastet e veprave penale që ndërlidhen me zgjedhjet. Kjo praktikë është ndërtuar prej vitit 2013 dhe ka vazhduar në të gjitha zgjedhjet. Tutje, IKD ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunëtorëve në shoqëri civile, për ta rritur mbikëqyrjen në reagimet e institucioneve të drejtësisë.¹⁷

Bazuar në praktikën e IKD-së në monitorimin e aktiviteteve të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për mbrojtjen e votës në zgjedhjet lokale dhe nacionale, rezulton se prej vitit 2013, zbatimi i PSV-ve ka shënuar progres të madh në ndërrimin e rolit të këtyre institucioneve. Qasja dhe roli i Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës¹⁸ është shndërruar në rol proaktiv, duke ndikuar drejtpërdrejtë në parandalimin dhe luftimin e veprave penale kundër të drejtës së votimit. Kjo më së miri vërehet tek reagimi efikas dhe efektiv, i cili ka ndikuar që në secilat zgjedhje, të ulet numri rasteve dhe personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve.¹⁹ Shih në grafikën në vazhdim trendin e personave të përfshirë në manipulime në zgjedhjet e mbajtura në vitet 2010²⁰, 2013²¹, 2014²² dhe 2017.²³

¹⁴ IKD intervistë me znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatore e lëndëve të zgjedhjeve. Gusht, shtator 2018.

¹⁵ IKD intervistë me z. Naim Rexha, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Gusht 2018.

¹⁶ Policia, Prokuroria dhe KQZ-ja të gatshme për zgjedhjet e 11 qershorit. Koha.net. 24 maj 2017. (Shih linkun <http://www.koha.net/arberi/20626/policia-prokuroria-dhe-kqz-ja-te-gatshme-per-zgjedhjet-e-11-qershorit/>)

¹⁷ *Shënim*: IKD në vitin 2016 dhe 2017 ka përfshirë në monitorim organizata partnere si Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Iniciativa për Progres (INPO).


¹⁸ IKD intervistë me z. Bajram Shabani, Togër i Policisë së Kosovës - Koordinator për Zgjedhje. Gusht 2018.

¹⁹ Musliu B. dhe Miftaraj E. “Drejtësia në zgjedhjet 2017: Raport rreth përgjigjes së organeve të drejtësisë ndaj kryesve të veprave penale kundër të drejtave të votimit”. Gusht 2017. Instituti i Kosovës për Drejtësi.

²⁰ *Shënim*: Sipas këtyre të dhënave të siguruara nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, rezulton se për zgjedhjet e vitit 2010, Prokuroritë kanë ngritur 448 kallëzime penale për keqpërdorime në zgjedhje ku përfshihen 2661 persona, kryesisht komisionerë të partive politike. Tetor 2018.

²¹ *Shënim*: Sipas këtyre të dhënave të siguruara nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, rezulton se për zgjedhjet e vitit 2013, Prokuroritë kanë ngritur 197 kallëzime penale për keqpërdorime në zgjedhje ku përfshihen 261 persona, kryesisht komisionerë të partive politike. Tetor 2018.

²² *Shënim*: Sipas këtyre të dhënave të siguruara nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, rezulton se për zgjedhjet e vitit 2014, Prokuroritë kanë ngritur 25 kallëzime penale për keqpërdorime në zgjedhje ku përfshihen 40 persona, kryesisht komisionerë të partive politike. Tetor 2018.




Grafika 1: Përqindja e personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve ndër vite.

Këto të dhëna, dëshmojnë se roli proaktiv i institucioneve të drejtësisë, ka qenë përcaktues që të ulet ndjeshëm numri i manipuluesve të zgjedhjeve. Politika e ndjekjes dhe reagimi i shpejtë, në të gjitha rastet e incidenteve në ditën e votimit, ka sjellë këtë rezultat pozitiv të uljes së rasteve të manipulimeve në ditën e votimit, për çka IKD ka vlerësuar përkushtimin e këtyre institucioneve në zbatimin e PSV-ve.

Përtej këtyre kallëzimeve penale të iniciuara nga vetë Prokuroritë, kallëzime penale kanë ngritur edhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Shih më poshtë grafikunin për numrin e personave ndaj të cilëve kanë ngritur kallëzime penale këto dy institucione për zgjedhjet e vitit 2010 dhe 2013.²⁴

²³ *Shënim:* Sipas këtyre të dhënave të siguruar nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, rezulton se për zgjedhjet e vitit 2017, Prokuroritë kanë ngritur 23 kallëzime penale për keqpërdorime në zgjedhje ku përfshihen 27 persona, kryesisht komisionerë të partive politike. Tetor 2018.

²⁴ *Burimi:* Të dhënat janë siguruar nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula. Tetor 2018.



Grafika 2: Kallëzimet penale për zgjedhje të ngritura nga PZAP dhe KQZ.

Për zgjedhjet e vitit 2010, PZAP dhe KQZ kanë ngritur 227 kallëzime penale kundër 1145 personave, ndërsa për zgjedhjet e vitit 2013 kanë ngritur 143 kallëzime penale kundër 143 personave.

Bazuar në të gjitha këto përvoja të zgjedhjeve prej vitit 2010 e tutje, vërehet se vetëm pas miratimit të PSV-ve në vitin 2013 dhe zbatimit të tyre në praktikë, është arritur që të shënohet progres në parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimeve në zgjedhje në ditën e votimit.

b. Mangësitë e PSV-ve, politikë e kufizuar e ndjekjes

IKD vlerëson se dita e votimit, nuk do të jetë më problematike, nëse institucionet e drejtësisë, do të zbatojnë me përpikëri PSV-të dhe obligimet ligjore në parandalim dhe ndjekje të kryesve të veprave penale kundër të drejtës së votimit. Problem, mbeten format tjera të manipulimit të proceseve zgjedhore dhe keqpërdorimit të drejtës së votuesve. Fjala është për keqpërdorimet që ndodhin para dhe pas ditës së votimit në procesin e zgjedhjeve.

IKD në raportin analitik rreth politikës së ndjekjes dhe dënimeve në rastet e krimeve të zgjedhjeve të publikuar në vitin 2012 “Krimi i organizuar në zgjedhje”, ka ngritur shqetësime në lidhje me politikën e ndjekjes, e cila është kufizuar vetëm në ndjekjen e komisionerëve të partive politike, të cilët ishin përfshirë në manipulimin e votave. Prokurori i Shtetit nuk kishte shkuar tutje për të hetuar elementet e krimit të organizuar, përkundër faktit, se ishin rreth 5000 komisionerë të përfshirë në manipulimin e votave në zgjedhjet e vitit 2010. IKD vlerëson se

Prokuroria ka amnistuar kryesit e këtyre manipulimeve në vitin 2010, të cilët kanë qenë organizator, shtytës dhe financues të këtyre aktiviteteve kriminale në zgjedhje.²⁵

IKD vlerëson se krimet e zgjedhjeve janë të ndërlidhura me aktivitete tjera kriminale, të cilat ndërlidhen me zgjedhjet por nuk fillojnë dhe nuk mbarojnë me ditën e votimit. Në këtë drejtim, përfshihen disa faza dhe fenomene të ndryshme, të cilat burojnë nga mënyra e dyshimtë e financimit të partive politike, çështje kjo, e cila është ngritur vazhdimisht IKD dhe organizatat tjera të shoqërisë civile.²⁶

Përderisa, PSV-të në një masë të madhe koncentrohen në ndërmarrjen e veprimeve të policisë dhe prokurorisë në ditën e votimit të zgjedhjeve, fushatës parazgjedhore duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur, përmes plotësimit të PSV-ve në fazën para dhe pas ditës së votimit në zgjedhje.

IKD duke vlerësuar veprimet e partive politike dhe kandidatëve të caktuar në investimet që bëjnë në fushatë zgjedhore dhe pas marrjes së pushtetit me shpërblimin e bizneseve me tenderë publik vlerëson se nuk ka veprime standarde të policisë dhe prokurorisë në parandalim dhe ndjekje efikase të këtyre veprimeve të kundërligjshme. Ky efikasitet mundësohet përmes shqyrtimit të plotësimit të PSV-ve në këto dy faza të zgjedhjeve, para dhe pas ditës së votimit.

Në fazën para ditës së votimit, zgjedhjet përcillen me fushatë parazgjedhore, në të cilën, po të kishte një ndjekje efikase të PSh-së do të mund të zbuloheshin shumë veprime të kundërligjshme, të cilat hynë në sferën kriminale. Fjala është për financimin e partive politike. Këto të fundit, zakonisht bëjnë shpenzime shumë më të mëdha sesa që deklarojnë në fushata zgjedhore. Financat e tyre vazhdimisht kanë mbetur jotransparente për publikun në shumicën e rasteve. Në anën tjetër, biznese të afërta me partitë politike në qeverisje, të cilat kanë financuar fushatat e partive, janë shpërblyer me tenderë publikë.²⁷ Në mënyrë që të ketë përgjigje adekuatë në drejtim të ndjekjes efikase dhe efektive në këtë drejtim, IKD rekomandon plotësimin e PSV-ve, të cilat do të mundësonin parandalimin dhe luftimin e veprave penale që kryhen para dhe pas ditës së votimit të zgjedhjeve.

Në fazën para ditës së votimit, fazë kjo në të cilën partitë politike zhvillojnë fushatë zgjedhore, gjatë monitorimit të reagimit të Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës, IKD ka gjetur se këto institucione nuk i kushtojnë rëndësi të veçantë monitorimit të aktiviteteve të financimit të fushatave të partive politike apo individëve të caktuar nga burimet e dyshimta. Në këtë drejtim,

²⁵ Musliu B. dhe Gashi A. *“Krimi i organizuar në zgjedhje: Analizë e politikës së ndjekjes dhe dënimeve”*. 6 qershor 2012, Prishtinë. Instituti i Kosovës për Drejtësi.

²⁶ *Shënim*: IKD dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile vazhdimisht kanë ngritur shqetësime për financimin e dyshimtë të partive politike në Kosovë, të cilat është kërkuar që të jenë pjesë e e hetimit dhe ndjekjes së Prokurorit të Shtetit.

²⁷ “Persiatja e dështuar: Financimi i partive politike në Kosovë”. Çohu, dhjetor 2016. (Shih linkun http://cohu.org/repository/docs/Persiatja_e_Deshtuar_ALB-FINAL-Print-Bleed-v1_175837.pdf)

duhet ndërtuar PSV, të cilat mundësojnë monitorimin e aktiviteteve të fushatës zgjedhore të partive politike. IKD rekomandon që PSh së bashku me ekipe hetuesish policor të monitorojnë aktivitetet e fushatës zgjedhore, duke mbledhur edhe raportimet që publikohen në media si dhe duke ofruar qasje për publikun për të informuar në linjë të sigurtë të komunikimit në mënyrë anonime përmes telefonit dhe internetit për shpenzimet e fushatës së partive politike.

IKD vlerëson se një qasje e tillë, do të ndikonte në parandalimin e financimit të dyshimtë të partive politike, të cilat, pas informimit që PSh do të heton këto veprimtari të financimit të fushatave, do të minimizonin aktivitetet e financimit të dyshimtë dhe më pas poqëse do të ndodhnin këto veprime të dyshimta, do të ndiqeshin me efikasitet nga organet e ndjekjes.

Në Kosovë financimi i partive politike bazohet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme²⁸ dhe Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.²⁹ Me ndryshimet e Ligjit mbi financimin e subjekteve politike, të bëra në vitin 2012, ishte rritur buxheti nga i cili do të përfitojnë partitë politike, nga 0.17% në 0.34% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Gjithashtu, përveç këtij buxheti, subjektet politike përfitojnë edhe nga fondi për fushatat elektorale, i cili arrin deri në 0.05% të buxhetit të Kosovës. Në këtë situatë, partitë politike kërkojnë përkrahje nga bizneset dhe qytetarët në mënyrë që fushatat e tyre zgjedhore të kenë efekt për të arritur qëllimin për të arritur në pushtet.

Në anën tjetër, pasqyrat financiare të shumicës së subjekteve politike vazhdojnë të mbesin të paqarta dhe jopublike për qytetarët, rrjedhimisht votuesit e tyre. Një problem i ngritur vazhdimisht nga shoqëria civile është mospërputhja e shpenzimeve reale të partive politike me të hyrat e deklaruar. Kjo situatë ka ndikuar që politika dhe biznesi të jenë të pandashëm. Politika luftojnë për pushtet përmes të cilit shpagojnë financuesit e fushatave, në këto raste bizneset, ku e gjithë kjo zhvillohet jashtë kornizave ligjore. Në këtë drejtim, ka pasur shumë raportime për fenomenin e shpagimit të bizneseve me tenderë publik në të gjitha nivelet qeveritare.³⁰ Gjetjet e vazhdueshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare dëshmojnë se sistematikisht ka pasur favorizime në tenderët publik, të cilët nuk janë zbatuar në praktikë në përputhje me kontratat dhe se kompanitë janë amnistuar vazhdimisht.

IKD këtë fenomen e ka trajtuar në raportet paraprake në kuadër të programit “Drejtësia në Zgjedhje”, dhe përkundër ndërlidhjes së ngushtë të politikës me biznesin, prokurorët nuk kanë

²⁸ *Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji numër 03L-073*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 5 qershor 2008. Po ashtu, *Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji numër 03L-072*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.

²⁹ *Ligji për financimin e subjekteve politike, ligji numër 03/L-174, neni 7 mbi fondin për mbështetjen e subjekteve politike*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 21 tetor 2010. Po ashtu, *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, ligji numër 04/L-058, neni 2*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 12 janar 2012.

³⁰ Kastriot Jahaj, “Shpague financuesit e fushatës me tender”. *Gazeta Jeta në Kosovë*, 19 mars 2012. (Shih linkun <http://www.gazetajn.com/?cid=1,3,1671>).

zhvilluar hetime, të cilat do të zbardhnin financimin e dyshimtë të partive politike. Ky lloj i financimit të partive apo kandidatëve dhe shpagimi me tender publikë i bizneseve që kanë financuar partitë politike janë fushat, në të cilat prokurorët kanë dështuar të zhvillojnë ndjekje të avancuar për të zbardhur format e manipulimit të zgjedhjeve.

Fenomenin e ndërlikohjes së ngushtë të politikës me biznesin, para dhe pas ditës së votimit, Prokurori i Shtetit duhet ta ketë në fokus të hetimit dhe ndjekjes për të arritur tek shkaku i vërtetë i manipulimit të procesit të zgjedhjeve. IKD rekomandon që PSh të ndërmarr veprime në drejtim të analizimit të veprimeve në fushën e prokurimit publik, fushë kjo në të cilën buxheti publik keqpërdoret në formën e shpërblimit të bizneseve dhe financueve të tjerë, të cilët kanë financuar partitë politike apo kandidatët e caktuar në fushata zgjedhore.

Tani në këtë fazë, hartimi dhe zbatimi i PSV-së për monitorimin dhe mbledhjen e informacioneve për financimin e fushatave zgjedhore nga bizneset apo individët për partitë politike, do të mundësonte një pistë të mirë të hetimit dhe ndjekjes për prokurorët, të cilët do obligoheshin të hetonin lidhjet e financimit të partive politike dhe shpërblimit të financuesve me tenderë publik.

Në këtë formë, do të mundësohej fillimisht parandalimi i financimit të dyshimtë të tenderëve publik tek bizneset apo individët që kanë financuar partitë politike, të cilat, pas informimit që PSh do të hetoi këto veprimtari të financimit, do të minimizonin aktivitetet e financimit të dyshimtë të bizneseve përmes tenderëve publik dhe më pas poqëse do të ndodhnin këto keqpërdorime, ato do të ndiqeshin me efikasitet nga organet e ndjekjes.

IKD duke i pasur parasysh të gjitha këto veprime në fushën e prokurimit publik dhe ndërlikohjes së politikës me biznesin, rekomandon që PSh të ndërmarr veprime në drejtim të monitorimit dhe analizimit të veprimeve në fushën e prokurimit publik për të hetuar dhe ndjekur shpërblimin me tenderë publik të financuesve të partive politike. Ky monitorim do duhej të zhvillohej përmes PSV-së së bashku me ekipet e hetuesve policor, të cilët do të fokusoheshin në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik, duke mbledhur edhe raportimet që publikohen në media si dhe duke ofruar qasje për publikun për të informuar në linjë të sigurt të komunikimit në mënyrë anonime përmes telefonit dhe internetit për shpërblimin me tenderë publikë të bizneseve që kanë financuar partitë politike.

6. Politika e dënimeve në rastet e krimeve të zgjedhjeve

Sistemin gjyqësor³¹ dhe sistemi prokurorial³² në Kosovë pas manipulimit masiv të zgjedhjeve të vitit 2010 kanë vendosur që lëndët e krimeve të zgjedhjeve t'i trajtojnë me prioritet. IKD duke monitoruar sistematikisht trajtimin e lëndëve të zgjedhjeve, vazhdimisht ka dhënë vlerësime për dështimet e sistemit prokurorial në politikën e ndjekjes dhe sistemin gjyqësor për politikën joadekuatë të dënimeve, të cilat nuk e kanë arritur qëllimin e dënimit.

Sidoqoftë, IKD ka vlerësuar politikën e ndjekjes për rastet e krimeve të zgjedhjeve të vitit 2010. Edhe pse reagimi kishte qenë i vonshëm dhe këto krime nuk ishin parandaluar, veprimet e prokurorëve në ngritjen e kallëzimeve penale ndaj mbi 2500 komisionerëve të partive politike kanë ndikuar pozitivisht tek të gjithë akterët dhe vetë militantët e partive politike që të zbrapsen nga tentimi për të manipuluar votat e qytetarëve.

Sikurse në të kaluarën, IKD ngritë shqetësimin për mungesën e një bazë unike të të dhënave në mes të Policisë, Prokurorisë dhe Gjyqësorit në lidhje me rastet e zgjedhjeve. Ende nuk ka të dhëna, të cilat mund të tregojnë me saktësi jetën e lëndëve të krimeve të zgjedhjeve prej regjistrimit deri në përfundim. Megjithatë, disa të dhëna të siguruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK),³³ dëshmojnë për një numër të madh të rasteve të iniciuara për krimet e ndodhura në zgjedhjet e vitit 2010, 2013, 2014 dhe 2017. Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur të dhënat e KGJK-së për të gjitha këto zgjedhje të mbajtura në Kosovë.

³¹ IKD intervistë me z. Shkëlzen Maliqi, Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Gusht, shtator 2018.

³² IKD intervistë me znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatore e lëndëve të zgjedhjeve. Gusht, shtator 2018.

³³ *Shënim:* Të dhënat e KGJK-së të siguruar pamundësojnë analizimin e rrjedhës së lëndëve të njëjta të proceduara në gjyqësor. Prandaj, IKD ka bërë përshkrimin e rasteve dhe i ka komentuar ato për numrin e lëndëve të trashëguara, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhur në fund.

Lëndët penale që ju takojnë zgjedhjeve të organizuara sipas viteve	Gjykatat (Dep. i Përgjith.- DP) (Dep. i Krimeve të Renda - DKR)	Kodi Penal (KPK - Kodi i vjetër; KPRK - Kodi i ri)	Numri i lëndëve të zgjidhura													
			Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	Lëndë të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Loji i dënimit				Akgykim Lirues	Akgykim Refuzues	Parashkrim		Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese
						Dënim me burgim	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Dënime tjera			Parashkrim relativ	Parashkrim absolut			
2010	Ish-Gj.K.	KPK	113	19	132	6	8	5	2	0	1	0	0	22	65	67
2010	Ish-Gj.Q.	KPK	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
2013	Gj.Th. - DP	KPK	104	20	124	0	0	1	5	0	0	0	4	79	89	35
2013	Gj.Th.- DP	KPRK	5	8	13	0	1	1	0	0	0	0	0	6	8	5
2013	Gj.Th. DKR	KPK	45	182	227	2	0	2	0	0	3	0	0	1	8	219
2013	Gj.Th.DKR	KPRK	0	22	22	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1	21
2014	Gj.Th. - DP	KPRK	29	5	34	0	0	1	0	0	1	0	0	0	2	32
2014	Gj.Th. DKR	KPRK	249	110	359	9	8	109	0	3	18	0	0	17	164	195
2017	Gj.Th.DP	KPRK	88	0	88	0	0	0	0	0	1	0	0	1	0	87
2017	Gj.Th.DKR	KPRK	227	88	315	3	3	84	0	3	14	0	2	2	111	204

Tabela 2: Trajtimi i rasteve të zgjedhjeve ndër vite nga Gjykatat Themelore.

Sipas të dhënave të KGJK-së, se për zgjedhjet e vitit 2010, aso kohe ish-Gjykatat Komunale kanë pasur në punë 132 lëndë të krimeve të zgjedhjeve, prej tyre i kanë zgjidhur 65 lëndë, ndërsa kanë mbetur pa zgjidhur 67 lëndë. Ndërsa, ish-Gjykatat e Qarkut i kanë pasur 3 lëndë në punë, të cilat ende figurojnë të pazgjidhura. Në tërësi, rezulton se janë mbi 2500 komisionerë ndaj të cilëve janë ngritur kallëzime penale për zgjedhjet e vitit 2010. Rrjedhimisht nëse bëhen krahasime me numrin e personave të akuzuar për zgjedhjet pasuese (2013, 2014 dhe 2017) rezulton se këta mbi 2500 të cilëve janë ngritur kallëzime penale paraqesin 89% e personave ndaj të cilëve janë ngritur kallëzime penale në tërësi për të gjitha këto zgjedhje të mbajtura.

Në zgjedhjet e vitit 2013, kishte raste të iniciuara ndaj 261 personave në ditën e votimit. Megjithatë, në të dhënat e KGJK-së, rezulton se Gjykatat Themelore në Departamentin e Përgjithshëm sipas Kodit të vjetër Penal, kanë trashëguar 104 lëndë të pazgjidhura dhe kanë pranuar 20 lëndë të reja. Për këto zgjedhje kanë zgjidhur 89 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 35 lëndë të zgjedhjeve. Poashtu, në këtë Departament të Përgjithshëm të Gjykatave Themelore, sipas Kodit të ri Penal, janë trashëguar 5 lëndë të pazgjidhura, janë pranuar 8 lëndë të reja, janë zgjidhur 8 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 5 lëndë të zgjedhjeve.

Të dhënat e KGJK-së, tregojnë se Gjykatat Themelore për zgjedhjet e vitit 2013 kanë lëndë të zgjedhjeve edhe në Departamentin e Krimeve të Rënda. Në këtë Departament, ka lëndë të zgjedhjeve të regjistruara sipas Kodit të vjetër Penal, ku rezulton se janë trashëguar 45 lëndë të pazgjidhura të zgjedhjeve, kanë pranuar 182 lëndë të reja, kanë zgjidhur 8 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 219 lëndë të zgjedhjeve. Në këtë Departament, sipas Kodit të ri Penal, nuk ka pasur lëndë që janë trashëguar, janë pranuar 22 lëndë të reja, është zgjidhur vetëm 1 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 21 lëndë të zgjedhjeve.

Të dhënat e KGJK-së për zgjedhjet e vitit 2014, tregojnë se Gjykatat Themelore në Departamentin e Përgjithshëm sipas Kodit të ri Penal, kanë trashëguar 29 lëndë të pazgjidhura të zgjedhjeve, kanë pranuar 5 lëndë të reja, kanë zgjidhur 2 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 32 lëndë të zgjedhjeve. Ndërsa në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore, sipas Kodit të ri Penal, janë trashëguar 249 lëndë të pazgjidhura, janë pranuar 110 lëndë të reja, janë zgjidhur 164 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 195 lëndë të zgjedhjeve.

Të dhënat e KGJK-së për zgjedhjet e vitit 2017, tregojnë se Gjykatat Themelore në Departamentin e Përgjithshëm sipas Kodit të ri Penal, kanë trashëguar 88 lëndë të pazgjidhura të zgjedhjeve, nuk kanë pranuar lëndë të reja, ndërsa 1 lëndë është zgjidhur në mënyrë tjetër, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 87 lëndë të zgjedhjeve. Ndërsa në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore, sipas Kodit të ri Penal, janë trashëguar 227 lëndë të pazgjidhura, janë pranuar 88 lëndë të reja, janë zgjidhur 111 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 204 lëndë të zgjedhjeve.

Politika e dënimeve, bazuar në këto të dhëna të KGJK-së, rezulton se numri më i madh i dënimeve janë shqiptuar më gjatë, ndërsa minimalisht ka dënime me burgim efektiv. IKD vlerëson se kjo politikë e dënimeve nuk është adekuate dhe nuk e arrin qëllimin e dënimit.

7. Monitorimi i seancave gjyqësore lidhur me rastet e krimeve të zgjedhjeve

IKD në kuadër të monitorimit sistematik që bënë në shtatë Gjykatave Themelore në Kosovë si dhe Gjykatës së Apelit, gjatë vitit 2018, ka monitoruar edhe dhjetëra seanca gjyqësore që kanë pasur të bëjnë me veprat penale kundër të drejtës së votimit.

Shumica e këtyre seancave gjyqësore të monitoruara nga IKD³⁴ kanë pasur të bëjnë me të akuzuar për veprat penale në kuadër të kapitullit XVIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Numri i seancave të monitoruara:	30
Numri i rasteve të monitoruara:	22
Numri i personave të akuzuar:	89
Numri i personave të akuzuar për zgjedhjet e vitit 2010:	76
Numri i personave të akuzuar për zgjedhjet e vitit 2013:	5
Numri i personave të akuzuar për zgjedhjet e vitit 2014:	7
Numri i personave të akuzuar për zgjedhjet e vitit 2017:	1
Numri i personave të akuzuar nga kombësia shqiptare:	81
Numri i personave të akuzuar nga kombësia serbe:	8
Numri i të akuzuarve meshkuj:	60
Numri i të akuzuarve femra:	29

Tabela 3: Numri i seancave të monitoruara nga IKD në lidhje me rastet e zgjedhjeve.

Siç vërehet, numri më i madh i rasteve të trajtuara në vitin 2018, i takon rasteve të zgjedhjeve të vitit 2010. Kjo dëshmon për një dështim të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, që këto raste të trajtohen në përputhje me obligimet ligjore dhe politikat e KGJK-së dhe KPK-së që të trajtohen me prioritet.

Numri i personave të dënuar:	16
Numri i personave të dënuar nga kombësia shqiptare:	16
Numri i personave të dënuar nga kombësia serbe:	0
Numri i personave të dënuar për zgjedhjet e vitit 2010:	15
Numri i personave të dënuar për zgjedhjet e vitit 2013:	0
Numri i personave të dënuar për zgjedhjet e vitit 2014:	1
Numri i personave të dënuar për zgjedhjet e vitit 2017:	0
Të dënuar me kusht (3 muaj burgim, me periudhe verifikimi prej 1 viti)	16

Tabela 4: Numri i personave të dënuar për zgjedhje në rastet e monitoruara nga IKD.

Gjatë vitit 2018, siç shihet nga të dhënat e lartëcekura, sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës më së shumti është duke u marrë me rastet për veprat penale të kryera para 8 viteve, përkatësisht në zgjedhjet e vitit 2010. Nga 16 të dënuarit gjatë këtij viti, 15 prej tyre janë të dënuar për zgjedhjet e vitit 2010, ndërsa prej 89 të akuzuarve, 76 janë për zgjedhjet e vitit 2010.

³⁴ *Shënim:* Të gjitha seancat e monitoruara dhe raportuara gjenden në portalin “Betimi për Drejtësi” (www.betimiperdrejtesi.com).

Në këto raste personat e përfshirë në manipulime të zgjedhjeve akuzohen për kryerjen e veprave penale të mashtrimit në votime, falsifikimit të rezultateve zgjedhore, keqpërdorim të detyrën zyrtare gjatë zgjedhjeve dhe keqpërdorim të së drejtës së votimit, ku dënimet variojnë prej 6 muaj deri në 5 vite burgim efektiv. Megjithatë, politika e dënime në të gjitha këto raste është shqiptimi i dënimeve me kusht. Madje, dënimi me kusht ka qenë 3 muaj burgim efektiv, me periudhë verifikimi në kohëzgjatje prej 1 viti. Pra, në të gjitha këto raste, Gjykatat kanë shqiptuar dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor.

Shumica dërmuese e personave të akuzuar janë nga kombësia shqiptare. Sa i përket gjinisë, dominon gjinia mashkullore me 67.4% apo 60 persona, për dallim nga gjinia femërore me 32.5% apo me 29 persona.

Një karakteristikë është sa i përket akuzimit të personave për keqpërdorim të së drejtës së votimit, përkatësisht për votim me kusht dhe për votim të rregullt (votim i dyfishtë). Meqenëse kjo vepër penale është e dënueshme deri në 3 vite, në shumicën e rasteve është parë se prokurorët shkojnë me aktakuza të drejtëpërdrejta, parkatësisht nuk zhvillojnë hetime. Në këtë mënyrë, të njëjtit nuk bëjnë një ekspertizë grafologjike lidhur me atë nëse nënshkrimi i personit të dyshuar në listën e votuesve të rregullt dhe atyre me kusht është i njëjtë. Si rrjedhojë, kjo ekspertizë duhet të bëhet gjatë shqyrtimit gjyqësor. IKD vlerëson se kjo ngritë dy çështje. Çështja e parë është se një pjesë e hetimeve, e që në këtë rast është pjesa kryesore, nuk kryhet gjatë fazës së hetimeve në prokurori por gjatë fazës së gjykimit në Gjykatë. Çështja e dytë është se në rastet kur ekspertiza grafologjike konstaton se nënshkrimi nuk është i njëjtë në të dy listat, prokurori tërhiqet nga aktakuza, dhe kjo ndodh pas një periudhe shumë të gjatë, duke pasur parasysh tempon e përfundimit të këtyre rasteve. Në këtë mënyrë, personi i dyshuar dhe akuzuar mbahet një kohë të gjatë si i dyshuar dhe një kohë edhe më të gjatë si i akuzuar, dhe krejt në fund prokurori tërhiqet, dhe në këtë mënyrë i akuzuari persekutohet pa kurrfarë baze, duke ndikuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

IKD bazuar në të gjitha këto raste gjyqësore të monitoruara dhe analizuara, vlerëson se politika e hetimit, ndjekjes dhe dënimit ka qenë joadekuate. Hetimet e zhvilluara nuk janë zhvilluar profesionalisht, prokurorët kanë dështuar të shkojnë tutje me hetime dhe janë kufizuar vetëm tek kryerja e veprave nga ana e komisionerëve, por nuk kanë zhvilluar hetime për të gjetur financuesit dhe organizatorët që kanë shtyrë komisionerët të manipulojnë votat për partitë politike dhe për kandidatët e partive politike. Gjithashtu, politika e dënimeve nga gjykatësit, duke shqiptuar në shumicën e rasteve dënime me kusht, IKD vlerëson se nuk e arrin qëllimin e dënimit. Megjithëse, IKD ka parasysh që në këto raste, palët e përfshira në një farë forme kanë vuajtur dënimet, sepse u janë kufizuar të drejtat, duke i mbajtur për gati një dekadë nën akuzë dhe procedura gjyqësore. Në këtë drejtim, IKD vlerëson se prokurorët dhe gjykatësit kanë dështuar të trajtojnë këto raste në kohë të arsyeshme, në përputhje me obligimet ligjore dhe politikat e sistemit prokurorial dhe sistemit gjyqësor që këto lëndë të trajtohen me prioritet.

8. Rekomandimet e IKD-së për plotësimin dhe ndryshimin e PSV-ve

IKD ka vlerësuar në vazhdimësi koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës lidhur me reagimin institucional në mbrojtjen e procesit zgjedhor dhe në avancimin e ndjekjes dhe dënimit të rasteve që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Përderisa, PSV-të në një masë të madhe koncentrohen në ndërmarrjen e veprimeve të policisë dhe prokurorisë në ditën e votimit të zgjedhjeve, fushatës parazgjedhore duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur, përmes plotësimit të PSV-ve në fazën para dhe pas ditës së votimit në zgjedhje.

IKD duke vlerësuar veprimet e partive politike dhe kandidatëve të caktuar në investimet që bëjnë në fushatë zgjedhore dhe pas marrjes së pushtetit me shpërblimin e bizneseve me tenderë publik rekomandon veprime standarde të policisë dhe prokurorisë në parandalim dhe ndjekje efektive të këtyre veprimeve të kundërligjshme. Ky efikasitet mundësohet përmes plotësimit të PSV-ve në këto dy faza të zgjedhjeve, para dhe pas ditës së votimit.

- Në fazën para ditës së votimit, zgjedhjet përcillen me fushatë parazgjedhore, në të cilën, po të kishte një ndjekje efektive të PSh-së do të mund të zbuloheshin shumë veprime të kundërligjshme, të cilat hynë në sferën kriminale. Fjala është për financimin e partive politike. Këto të fundit, zakonisht bëjnë shpenzime shumë më të mëdha sesa që deklarojnë. Financat e tyre vazhdimisht kanë mbetur jotransparente për publikun në shumicën e rasteve. Në anë tjetër, biznese të afërta me partitë politike në qeverisje, të cilat kanë financuar fushatat e partive, janë shpërblyer me tenderë publikë. Në mënyrë që të ketë përgjigje adekuate në drejtim të ndjekjes efektive dhe efektive në këtë drejtim, IKD rekomandon miratimin e PSV-ve, të cilat do të mundësonin parandalimin dhe luftimin e veprave penale që kryhen para dhe pas ditës së votimit të zgjedhjeve.

Në fazën para ditës së votimit, fazë kjo në të cilën partië politike zhvillojnë fushatë zgjedhore, IKD rekomandon që PSh të caktojë prokurorë të veçantë për zgjedhjet për secilën komunë të Kosovës. Detyrat e këtyre prokurorëve, do të fokusoheshin në monitorimin e aktiviteteve të fushatës parazgjedhore, përmes hetuesve të veçantë, përmes informacioneve që publikohen në media dhe duke ofruar qasje për publikun për të informuar në një linjë të sigurt të komunikimit në mënyrë anonime përmes telefonit dhe internetit. Në këtë formë, do të mundësohej fillimisht parandalimi i financimit të dyshimtë të partive politike, të cilat, pas informimit që PSh do të hetoi këto veprimtari të financimit, do të minimizonin aktivitetet e financimit të dyshimtë dhe më pas poqëse do të ndodhnin këto veprime të dyshimta, do të ndiqeshin me efikasitet nga organet e ndjekjes.

- Pas përfundimit të ditës së votimit dhe shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, PSh duhet të ndërmarr veprime në drejtim të analizimit të veprimeve në fushën e prokurimit publik, fushë kjo në të cilën buxheti publik keqpërdoret në formën e shpërblimit të bizneseve dhe financueve të tjerë të cilët kanë financuar partitë politike apo kandidatët e caktuar në fushatë parazgjedhore.

Baza e të dhënave të PSh-së e krijuar gjatë fushatës zgjedhore për aktivitetet e financuara të partitë politike nga bizneset dhe individët e caktuar, do të mundësonte një pistë të mirë të hetimit për prokurorët, të cilët do obligoheshin të hetojnë lidhjet e financimit të partive politike dhe shpërblimit të financuesve me tenderë publik.

Tani në këtë fazë, hartimi dhe zbatimi i PSV-së për monitorimin dhe mbledhjen e informacioneve për financimin e fushatave zgjedhore nga bizneset apo individët për partitë politike, do të mundësonte një pistë të mirë të hetimit dhe ndjekjes për prokurorët, të cilët do obligoheshin të hetonin lidhjet e financimit të partive politike dhe shpërblimit të financuesve me tenderë publik.

Në këtë formë, do të mundësohej fillimisht parandalimi i financimit të dyshimtë të tenderëve publik tek bizneset apo individët që kanë financuar partitë politike, të cilat, pas informimit që PSh do të hetoi këto veprimtari të financimit, do të minimizonin aktivitetet e financimit të dyshimtë të bizneseve apo individëve përmes tenderëve publikë dhe më pas poqëse do të ndodhnin këto keqpërdorime, ato do të ndiqeshin me efikasitet nga organet e ndjekjes.

IKD duke i pasur parasysh të gjitha këto veprime në fushën e prokurimit publik dhe ndërlidhjen e politikës me biznesin, rekomandon që PSh të ndërmarr veprime në drejtim të monitorimit dhe analizimit të veprimeve në fushën e prokurimit publik për të hetuar dhe ndjekur shpërblimin me tenderë publik të financuesve të partive politike. Ky monitorim do duhej të zhvillohej përmes PSh-së së bashku me ekipet e hetuesve policor, të cilët do të fokusoheshin në monitorimin e aktiveve të prokurimit publik, duke mbledhur edhe raportimet që publikohen në media si dhe duke ofruar qasje për publikun për të informuar në linjë të sigurtë të komunikimit në mënyrë anonime përmes telefonit dhe internetit për shpërblimin me tenderë publikë të bizneseve që kanë financuar partitë politike.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).